



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr.295, datë 05.06.2024

PËR

**RENDITJEN E KANDIDATËVE NË PROCEDURËN E LËVIZJES PARALELE NË
GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË, PËR
POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 257, DATË 24.05.2023 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 05.06.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.257, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, për gatitur nga relatori i procedurës së përzgjedhjes z. Alban Toro,

VËREN:

I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES

1. Me Vendimin nr.256- nr.258, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e tre procedurave të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.02.2023.

2. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet e Këshillit nr.256- nr.258, datë 24.05.2023 (më poshtë referuar si vendimi 256/2023; 257/2023; 258/2023), kandiduan gjithsej 5(pesë) kandidatë, sipas tabelës së mëposhtme:

Pozicio ni	Nr.	Vendimi nr. 256	Vendimi nr. 257	Vendimi nr. 258
1		{...}	{...}	{...}
2		{...}	{...}	{...}

3	{...}	{...}	{...}
4	{...}	{...}	{...}
5	{...}	{...}	{...}

3. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimeve 256/2023; 257/2023; 258/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë vetëm 1(një) kandidat sipas vendimit respektiv:

Pozicioni	Nr.	Vendimi
		Nr.256/2023; 257/2023; 258/2023
1		{...}

3.1 Për kandidatin z. {...}, Këshilli me vendimin nr.45, datë 31.01.2024 ka vendosur: “Transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të suprimimit të pozicionit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë ku është caktuar në mënyrë të përhershme”

4. Në pozicionet nr. 256, nr. 257 dhe nr.258 që i referohet lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk kishte kandidatë të kualifikuar me 2(dy) vlerësime / apo 1(një) vlerësim. Në këto rrethana Këshilli, në zbatim të pikës 49 të vendimit 320/2020¹, me vendimin nr. 161, datë 03.04.2024ka vendosur: “*Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurën e lëvizjeve paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shpallur me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr.258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim*”. Po në këtë vendim u caktuan nëpërmjet procedurës së shortit edhe relatorët për çdo kandidat, përkatësisht për: znj. {...}, z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}.

5. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësisht të kandidatëve të kriterëve të mëposhtme.

1) “**përvojës profesionale minimale**”, sipas pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “6. *Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit*

¹ 49. Në rastin kur për pozicionin e lirë në një gjykatë të shkallës së parë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie janë tërhequr nga kandidimi, ose kur ata nuk janë kualifikuar për mosplotësim të kriterëve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional. Nëse për të njëjtat arsye procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë për këtë kategori kandidatësh, atëherë **ajo vazhdon për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional.**

nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”;

2) **“mospasjes masë disiplinore në fuqi”**, sipas pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“6. Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast seka në fuqi një masë disiplinore”;*

3) **“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”**, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... transferim, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”;*

6. Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që kanë aplikuar janë:

6.1 Kështu, për kandidaten *znj. {...}*, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 219 datë 25.04.2024, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6.2 Për kandidatin *z. {...}*, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ai të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 220 datë 25.04.2024, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6.3 Për kandidaten *znj. {...}*, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 221 datë 25.04.2024, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6.4 Për kandidaten *znj. {...}*, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve

të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 222 datë 25.04.2024, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Duke qenë se për këto pozicione të lira, ishin kualifikuar të gjithë kandidatët, Këshilli caktoi nëpërmjet shortit relatorin e përzgjedhjes për këto pozicione. Konkretisht, me Vendimin nr. 230, datë 26.04.2024, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. *Alban Toro*.

8. Më datë 26.04.2024, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75 e vijuese të Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, *“Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”*, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, si dhe për caktimin e relatorit. Tre nga kandidatët nuk paraqitën kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

8.1 Brenda afatit të parashikuar kandidati z. {...} me anë komunikim elektronik të datës 29.04.2024 paraqiti kërkesën për përjashtimin e relatorit, z. Toro dhe të anëtarëve të tjerë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës me arsyetimin si vijon: omissis...*“ Jam njohur me emailin tuaj, me anë të të cilit njoftohem për caktimin ndaj meje të z. Alban Toro, si relator për këto procedura përzgjedhjeje për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura përkatësisht me vendimet nr. 256, nr. 257 dhe nr. 258, datë 24.05.2023 dhe nëpërmjet këtij emaili bëhem me dije se kam të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Në përgjigje të këtij emaili, unë ju shpreh qëndrimin tim se jo vetëm z. Alban Toro por edhe anëtarët tjerë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës duhet të përjashtohet në këto procedura, për arsye sa vijon; Në këto procedura ka marrë pjesë edhe një kadidate e cila është komanduar në njësinë ndihmëse pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite të jetë e tillë, pra, kjo kadidate është në varësi marrëdhënie pune direkte me anëtarët e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës....etj.” ... omissis.*

8.2 Bazuar në nenin 76, pika 2 të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“2. Vendimi për përjashtimin e një anëtari nga shqyrtimi i një çështjeje në mbledhje plenare ose komision merret nga Këshilli, sipas rregullave të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji...”*, kërkesa e z. {...} për përjashtimin e relatorit z. Alban Toro dhe anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i kalon për shqyrtim mbledhjes plenare të Këshillit, kjo e fundit me vendimin nr. 256 date 09.05.2024 vendosi : *“Për refuzimin e kërkesës së z. {...} “Për përjashtimin e relatorit dhe*

të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkollës së Parë Tiranë”.

9. Siç u parashtrua, në pikën 4 të këtij vendimi, kandidatët e kualifikuar për pozicionet nr.256/2023; 257/2023; 258/2023 i përkasin kategorisë së kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional. Hapat dhe kriteret për renditjen e tyre janë parashikuar në mënyrë të detajuar në seksionin Ç.1 të Kreut VI të vendimit 320/2020.

10. Pika 102 e vendimit 320/2020 parashikon se: *“Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.”* Për sa më lart, në respektim edhe të përfundimeve të vendimit të Këshillit nr. 346, datë 27.06.2023², këtyre kandidatëve nuk u bëhet asnjë vlerësim nga Këshilli.

11.Në zbatim të pikës 106, të Vendimit të Këshillit 320/2020, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për kandidatët e kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikën dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori ka administruar edhe certifikatat e vlerësimit të Shkollës së Magjistraturës për secilin kandidat, si edhe listën e Klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për kandidatët e diplomuar në Qershor 2019 dhe kandidatët e diplomuar në Qershor 2020.

12.Konkretisht, lidhur me vlerësimet e Shkollës së Magjistraturës, për kandidatët u konstatua se:

12.1 Kandidatja *znj. {...}* e diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2016 qershor 2019) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4070.31 pikësh, nga 4450 të mundshme.

12.2 Kandidati *z. {...}* i diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2016 qershor 2019) ka marrë vlerësimin “Shumë Mirë”, me një total prej 4073 pikësh, nga 4450 të mundshme.

12.3 Kandidatja *znj. {...}* e diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2016-qershor 2019) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4129.37 pikësh, nga 4450 të mundshme.

12.4.Kandidatja *znj. {...}* e diplomuar në vitin akademik 2019-2020 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2018-qershor 2020) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 2990 pikësh, nga 3200 të mundshme.

² znj. {...}, z. {...} znj. {...} dhe znj. {...} përfshihen në shtojcën III të këtij vendimi- kategoria e kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

13. Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë pika 8 dhe 9 e Nenit 43 të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “8. Në rastet e lëvizjes paralele në gjykatë ose prokurori të shkallës së parë, kur nuk ka kandidime, sipas pikës 7, të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele hapet për magistratët, të cilët nuk janë vlerësuar dy herë. Ata renditen duke u bazuar njëkohësisht: a) në rezultatin e vlerësimit etik dhe profesional përkatës; b) në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magistratit të riemëruar sipas nenit 36 të këtij ligji. 9. Në rastet e lëvizjes paralele në gjykatë ose prokurori të shkallës së parë, kur nuk ka kandidime sipas pikës 8, të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele hapet për magistratët, të cilët nuk janë vlerësuar ndonjëherë. Ata renditen sipas pikës 8, shkronja “b”, të këtij neni.”

14. Po ashtu, për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të Vendimit 320/2020, dalë në zbatim të pikës 12, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “ 101. Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim.”

II. RENDITJA E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 257 DATË 24.05.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

15. Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 257, datë 24.05.2023, u përfshinë katër kandidatë, konkretisht: znj. {...}, z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e lëvizjes paralele ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe nuk kishin asnjë vlerësim etike dhe profesional, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “b”, pika 8, e nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në pikën 101 të Vendimit 320/2020.

16. Për renditjen e kandidatëve, u ndoq hapi i vetëm i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 8, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin Ç.1, Kreu VI, të Vendimit 320/2020.

17. Siç u parashtrua, edhe më sipër, sipas përcaktimeve të pikës 8, të nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe pikës 101, të Vendimit 320/2020 ku parashikohet se: “Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim ...”.

18. Referuar kriterit të renditjes, pra atij sipas “*renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës*”, për kandidatët u konstatua:

18.1 Për kandidaten znj. {...} a) Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3 vjeçare Tetor 2016 - Qershor 2019, kandidatja është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

18.2 Për kandidatin z. {...} a) Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3 vjeçare Tetor 2016 - Qershor 2019, kandidati është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

18.3 Për kandidaten znj. {...} a) Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3 vjeçare Tetor 2016 - Qershor 2019, kandidatja është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

18.4 Për kandidaten znj. {...} a) Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 2 vjeçare Tetor 2018 - Qershor 2020, kandidatja është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

19. Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “*renditjes së të diplomuarve*”, rezultoi që kandidatët znj. {...}, z. {...} znj. {...} dhe znj. {...}, të kenë nivelin e vlerësimit “*Shumë mirë*” në renditje. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të vlerësimit të Shkollës për kandidatët, identifikohen katër kandidatë me rezultate të njëjta në nivelin e vlerësimit, Për sa më sipër, duke qenë se të katër kandidatët e kanë nivelin e vlerësimit “*shumë mirë*” nga Shkolla e Magjistraturës, për pasojë, renditja e kandidatëve nuk mund të bëhet sipas nivelin të përgjithshëm.

20. Duke vijuar me përparësitë të parashikuara nga pika 103 nuk rezulton që ndonjë prej kandidatëve të ketë përvojë si gjyqtar i komanduar apo në skemën e delegimit.

21. Në pikën 105 të vendimit 320/2020 përcaktohet se: “*Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 103, të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.*”

22. Nga lista kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 257/2023, rezulton se ata i përkasin dy viteve akademikë të ndryshëm në diplomim nga Shkolla e Magjistraturës. Tre kandidatët gjenden, konkretisht: znj. {...}, z. {...} znj. {...} në listën e Klasifikimit të kandidatëve

për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në Qershor 2019 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës; znj. {...} në listën e Klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në Qershor 2020 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës. Qenia në vite akademike të ndryshëm nuk përbën pengesë ligjore për renditjen e tyre në pozicionin ku kandidojnë.

23. Nga listat e klasifikimit të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë të përcjellë nga shkolla e Magjistraturës, për vitin qershor 2019 dhe qershor 2020 ka rezultuar se:

i) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4070.31 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.46 % të pikëve totale;

ii) kandidati z. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4073 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.52 %, të pikëve totale.

iii) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4129.37 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 92.79 %, të pikëve totale

iv) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 2990 pikë, nga 3200 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 93.44 %, të pikëve totale

24. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, sipas listës së klasifikimit të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 257, datë 24.05.2023, ku më lart renditet kandidatja znj. {...}, ndërsa kandidatët znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} renditen pas saj.

25. Siç u argumentua më sipër, nuk ekziston pengesë ligjore për të kryer renditjen e kandidatëve të diplomuar në vite të ndryshme akademike, pasi renditja bazohet në vlerësimet e marra nga kandidatët e diplomuar në raport me pikët e mundshme. Znj. {...} është vlerësuar me 93.44 % të pikëve të mundshme, znj. {...} është vlerësuar me 92.79 %, të pikëve të mundshme, z. {...} është vlerësuar me 91.52 %, të pikëve të mundshme dhe znj. {...} është vlerësuar me 91.46 %, të pikëve të mundshme. Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 257, datë 24.05.2023, rezulton si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};
- 3) Z. {...};
- 4) Znj. {...}.

26. Bazuar në sa përcaktohet në pikat 18-24, të këtij vendimi, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 25 të tij, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 257 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

III. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

27. Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 257 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Seksionin DH, Kreu VI, të Vendimit 320/2020.

28. Gjatë shqyrtimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar për kandidatet në funksion të renditjes, përveç edhe korrektësinë e projektvendimit.

IV. KONKLUZIONI

29. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 257 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”,

VENDOSI:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr.257, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};
- 3) Z. {...};
- 4) Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, Znj {...}, z. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR